

VENDIM
Nr. 857, datë 21.10.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2015, NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 2 060 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në ndarjen “(7) Ministria e Financave”, në emërtesën “Punonjës shërbimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, fjalët “...tremujore...” zëvendësohen me “...gjashtëmujore...”;

b) Në ndarjet “(20) Ministria e Zhvillimit Urban”, “(23) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” dhe “(26) Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor” shtohen nëndarjet, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Emri i Institucionit	Nr. Punonjës	Emërtesa	Koha ditore	Periudhë kohore
(20) Ministria e Zhvillimit Urban	2			
Aparati i Ministrisë	1	Specialiste	8 orë / ditë	Tetor - Dhjetor
Aparati i Ministrisë	1	Specialiste	4 orë / ditë	Tetor - Dhjetor
(23) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	4			
Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR)	1	Punonjës protokolli	8 orë/ditë	Tetor - Dhjetor
Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR)	1	Teknik	8 orë/ditë	Tetor - Dhjetor
Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR)	1	Punonjës informacioni	8 orë/ditë	Tetor - Dhjetor
Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR)	1	Sanitar	8 orë/ditë	Tetor - Dhjetor
(26) Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	1			
Gjykata e Rrethit Tiranë	1	Sanitar	8 orë / ditë	2- muaj

